
RECENSIONE

EDMOND MALAJ: “DRISHTI. HISTORIA DHE FIZIONOMIA E NJË QYTETI MESJETAR SHQIPTAR”, KRISTALINA-KH, **Tiranë 2015, f.452**

Literaturës historiografike, respektivisht medievistikës, iu shtua edhe një studim i cili përmbush një boshllëk të konsiderueshëm. Kjo pasi studimi i qytetit mesjetar shqiptar është një tematikë pak e lëvruar.

Punimi monografik i prof. asoc. Edmond Malajt mbi historinë mesjetare të Drishtit përmbush një nevojë për historiografinë shqiptare. Përmasat e këtij vëllimi monografik i përshtaten më së miri historisë së pasur të këtij qyteti të rëndësishëm të Shqipërisë mesjetare. Për shkak edhe të pasurisë dokumentare, monografia është mjaft e pasur. Është padyshim meritë e autorit, që burimet e disponueshme i ka hulumtuar me hollësi dhe njëkohësisht i ka analizuar me rigorozitetin e duhur shkencor.

Monografia është e strukturuar në 10 krerë të ndarë në dy pjesë sipas një kriteri të gjetur kronologjiko-tematik. Kjo ndarje i përshtatet më së miri edhe tematikës së trajtuar përgjatë këtyre kapitujve, ku pjesa e parë e përbërë nga gjashtë kapituj ka si qëllim të pasqyrojë aspekte të veçanta nga historia e qytetit mesjetar të Drishtit.

Kapitulli i parë që i korrespondon pjesës së hyrjes përmban informacionet e duhura për nivelin e një punimi të tillë, ku autori ka sqaruar motivimin për ndërmarrjen e një studimi të tillë, gjendjen e studimeve mbi Drishtin mesjetar, si dhe qëllimin dhe metodologjitë e punimit.

Kapitulli i dytë analizon historinë e përgjithshme të qytetit nga zanafilla deri në periudhën venedikase. Në këtë kapitull jepet një kronologji e historisë së qytetit nga fillimet deri në shek.XV. Këtu trajtohet pozicioni gjeografik, etimologjia dhe struktura e qytetit. Gjithashtu trajtohet edhe sundimi i Balshajve dhe kërcënimet osmane. Për vetë rëndësinë e kësaj periudhe, për të kuptuar akoma më mirë periudhën pas shek.XV, ky kapitull edhe pse është i shkurtër për diapazonin kohor është shumë i ngjeshur me të dhëna ku pasqyrohen ngjarjet kryesore, politike-ushtarake që ndodhën në Drisht gjatë kësaj periudhe pothuaj mijëvjeçare.

Në dy kapitujt pasues, trajtohet nga i njëjti këndvështrim periudha venedikase deri pas pushtimit osman. Këtu një vend të rëndësishëm zë vendosja e sundimit venedikas në pellgun e Shkodrës si dhe ngjarjet e trazuara të dy dekadave të para të këtij sundimi. Trajtimi është shumë i detajuar. Aty del në pah më së miri rigoroziteti shkencor i autorit në analizimin e përballjeve politike të sundimit të ri me popullsinë vendase si dhe me përfaqësuesit e sundimit të mëparshëm, veçanërisht Balshajt por edhe me osmanët.

Në kapitullin e pestë sillen përpara lexuesit të dhëna shumë interesante rreth aspekteve administrative, arkitektonike të qytetit, si dhe të dhëna mbi përbërjen e popullsisë, mbi familjet drishtjane, etj. Kapitulli është i punuar shumë mirë, me detaje të shumta dhe analiza të hollësishme rreth marrëdhënieve të niveleve të ndryshme të pushtetit dhe të hierarkisë administrative. Përkundër faktit se këto marrëdhënie nuk dalin gjithnjë të qarta në dokumentacionin e kohës, autori ka arritur të japë një pasqyrë mjaft të detajuar dhe të qartë të këtyre aspekteve. Edhe kapitulli pasues ku trajtohet aspekti social i historisë së Drishtit është i pasur me të dhëna të detajuara rreth konstruktit të bashkësisë qytetare. Në mënyrë të detajuar trajtohet familja e Engjëllorëve, si origjina ashtu edhe të dhëna biografike rreth përfaqësuesve kryesorë të kësaj familje si Andrea Engjëlli e Palë Engjëlli. Trajtohen edhe familje të tjera fisnike të qytetit si Belli Humoi, Lepore Mazrekët, Palomba, Prekali Suma, Shpani, Ungri si edhe Barba Biancha, Bariloch, Dushmani, Manganja, Skepudar Sporo, Svinis, Tossil, Zaon, Zogi dhe familje më pak të dokumentuara.

Një kontribut i veçantë i autorit është shtjellimi i përbërjes etnike e sociale të qytetarëve. Grupe me të drejta të kufizuara ku përfshin Arbrit (albanenses), të Huajt (Forenses), Megulsët (Megulsi) dhe Sllavët.

Në kapitullin e shtatë trajtohen aspekte ekonomike dhe kulturore të Drishtit. Ai është i ndërtuar mbi një bazë të gjerë dokumentare dhe arrin të japë një panoramë të hollësishme të çështjeve që trajton. Autori shtjellon problematika rreth prodhimit dhe tregtisë, zanateve të ndryshme, monedhave dhe aspekteve të tjera kulturore.

Në kapitullin e tetë, trajtohet emigrimi i popullsisë dhe diaspora e re e Drishtit në Venedik. Këtu, mes të tjerash trajtohen me detaje të pasura emigrimi i popullsisë dhe diaspora drishtjane në Venedik, veçanërisht fisnikët drishtjanë në mërgim si Shpanët dhe Engjëllorët me gjenealogjitë përkatëse. Gjithashtu këtu pasqyrohet dhe analizohet një dokument i vitit 1547 mbi pronat e Engjëllorëve në Drisht si dhe Urdhri i Shën Gjergjit e lidhja e tij me Engjëllorët. Në nënkreun, "Pasuritë e Engjëllorëve sipas dokumentit", me të drejtë autori e vë në dyshim pretendimin e dokumentit rreth pasurive të engjëllorëve.

Pjesa e dytë e punimit, e cila përqendrohet tek historia kishtarë e dioqezës së Drishtit përbëhet nga tre kapituj shumë të pasur në informacione e të dhëna historike. Qëllimi i kësaj pjesë është që të jepet një pamje apo një përfytyrim i përgjithshëm i botës së pasur të krishterë të Drishtit mesjetar, duke hedhur vështrimin në aspekte të ndryshme. Autori jep të dhëna për disa aspekte të këtij institucioni, duke u nisur nga të dhënat mbi kishat e qytetit dhe të zonës përreth, pastaj duke vazhduar me historinë e ipeshkvijve, me statutet e Kapitullit të Katedrales së Drishtit, e duke përfunduar me aktivitetet e klerikëve drishtjanë në Raguzë, Venedik dhe vende të tjera.

Në kapitullin, “Të dhëna historike mbi Ipeshkvinë dhe klerin e Drishtit”, jepen të dhëna historike mbi Ipeshkvinë dhe klerin e Drishtit përgjatë shekujve duke bërë një ndarje logjike mes historisë së ipeshkvisë së Drishtit deri në shekullin XVI dhe më pas, ku jepen të dhëna rreth ipeshkvijve titullarë nga shek. XVI.

Kapitulli pasues, “Monumentet kishtarë dhe klerikët”, është shumë i pasur në informacion dhe në analizimin e këtij informacioni. Bëhet një ndërthurje mes informacioneve dokumentare rreth kishave të dokumentuara në qytet, si edhe rrënojave të kishave anonime. Autori ka dhënë një kontribut të vyeshëm në përpjekjen për të identifikuar rrënojat e kishave me të dhënat dokumentare të disponueshme.

Kapitulli përmbyllës pasqyron praninë dhe aktivitetin e klerikëve drishtjanë në Raguzë, sidomos roli i tyre laik si noterë dhe taksambledhës. Gjithashtu të dhëna interesante dhe të pasura jepen edhe për pjesëmarrjen e klerikëve në pelegrinazh.

Autori e ka pajisur monografinë edhe me një shtojcë dokumentare, e cila është integruar drejt dhe me vend në punim. Edhe zgjedhja e dokumenteve ilustruese mendojmë se është bërë në mënyrë të përkorë dhe përfaqësuese nga ana e autorit.

Pasqyra e burimeve të përdorura dhe bibliografia janë të pasura. Autori ka arritur të konsultojë pjesën dërrmuese të burimeve dokumentare të botuara, si dhe të bibliografisë rreth objektit të studimit. Pasqyrimi i burimeve të ilustrimeve të përdorura në punim padyshim përbën një detyrim shkencor të përmbushur saktësisht nga autori. Gjithashtu në përputhje të plotë me seriozitetin dhe përkushtimin e autorit, ai shoqërohet me një indeks emrash të vendeve dhe personave të përmendur në tekst, që e bën punimin më të manovrueshëm dhe më lehtësisht të konsultueshëm për të interesuarit.

Monografia është e pajisur me ilustrime dhe fotografi, të realizuara nga vetë autori, gjë që e shton vlerën dhe origjinalitetin e punimit.

Në përfundim mendojmë se punimi monografik i prof.as.dr. Edmond Malaj, është një pasurim i traditës së vyer të veprave historiografike që Instituti i Historisë ka dëshmuar vazhdimisht deri më sot. Kjo vepër do të shërbejë edhe si nxitje për të shuar kureshtjen rreth historisë së këtij qyteti mesjetar shqiptar jo vetëm për lexuesit e specializuar por edhe për publikun e gjerë të interesuar për temat historike dhe trashëgiminë tonë kulturore.

Dr. Ardian MUHAJ
Dr. Hasan BELLO

